

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6937
E enjte, 6 korrik 2023
Çmimi 0.40

Elvir Azizi emërohet drejtor i ri i ShSKUK-së

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, SOT VIZITON REPUBLIKËN E KOSOVËS

FAQE 3

E PAPRECEDENTË, KURTI KUSHTËZON TAKIMIN ME RAMËN NË PRISHTINË



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, do ta vizitojë sot (e enjte) Kosovën në kuadër të turit të tij në Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Serbi. Ndonëse kjo vizitë do të ndodhë, mbetet e paqartë nëse Rama do të

takohet me kryeministrin Albin Kurti, pasi ky i fundit ka kushtëzuar një takim të tillë me mbajtjen e mbledhjes së përbashkët të dy qeverive. Kurti ka thënë se më të rëndësishme e konsideron

mbledhjen e përbashkët të dy qeverive sesa takime të tjera. Ndërsa Rama nuk ka dashur ta komentojë deklaratën e Kurtit, duke thënë se për këtë çështje do të flasë në Prishtinë

LAJÇAKU NË PRISHTINË DHE BEOGRAD PËR ULJEN E TENSIONEVE NË VERI, PALËT NUK LËVIZIN NGA POZICIONET | FAQE 3



MINISTRIA E JASHTME DO TË ORGANIZOJË AKTIVITETE PËR DIASPORËN GJATË PUSHIMEVE NË KOSOVË | FAQE 5

AKTUALE



ZELENSKY: RUSIA PO PLANIFIKON PROVOKIME TË RREZIKSHME NË CENTRALIN BËRTHAMOR F. 2

MAPL-ja I SHPALL TË PAVLEFSHME VENDIMET E POZITËS PËR NDËRMARRJET PUBLIKE NË PRISHTINË F. 7

KOMUNA E VUSHTRRISË OFRON SHËRBIME PËR DIASPORËN EDHE TË SHTUNËN F. 6

EKONOMI



QEVERIA KRIJON SKEMË TË RE PENSIONALE PËR TË LARGUARIT NGA PUNA NË VITET '90 F. 8

MURATI KËRKON NGA BIZNESET T'I RRRITIN PAGAT E PUNËTORËVE F. 8

SPORT



KOSOVA MËSON KUNDËRSHTARËT PËR KUALIFIKIMET NË BOTËROR DHE EVROPIAN F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Rusia po planifikon provokime të rrezikshme në centralin bërthamor

KIEV, 5 KORRIK - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë se Rusia po planifikon “provokime të rrezikshme” në centralin bërthamor në Zaporizhja.

Zelensky, pas një telefonate me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, tha se trupat ruse që kanë pushtuar uzinën në territorin e kontrolluar nga Rusia në Ukrainën jugore, po përgatitin provokime. Sipas presidentit ukrainas, ai dhe Macroni ranë dakord ta mbajnë situatën nën kontroll së bashku me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA).

Deklarata e tij erdhi pasi Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Ukrainës tha se Rusia mund të përgatitet për një provokim “në të ardhmen e afërt” në territorin

e centralit, i cili është hequr nga linja, por ende kërkon energji elektrike dhe ujë për t'i ftohur të gjashtë reaktorët e saj. “Sipas informacionit operacional, objekte të huaja të ngjashme me mjetet shpërthyes u vendosën në çatinë e jashtme të njësisë së tretë dhe të katërt të energjisë të centralit bërthamor Zaporizhja”, tha Shtabi i Përgjithshëm.

Në njoftim u tha se forcat e armatosura të Ukrainës “nuk shkelin normat e së drejtës ndërkombëtare humanitare, monitorojnë dhe kontrollojnë situatën dhe janë të gatshme të veprojnë në çdo kusht”.

Në anën tjetër, Moska më 4 korrik akuzoi Kievin në lidhje me përgatitjet e supozuara për një incident në këtë uzinë.

Një këshilltar i agjencisë



bërthamore të Rosisë, Rosatom, Renat Karchaa, tha në televizionin shtetëror rus se Moska ka marrë informacione se natën e 5 korrikut “ushtria ukrainase do të përpiqet ta

sulmojë centralin bërthamor të Zaporizhjas”. Ai pretendoi se Ukraina planifikoi të përdorte “armë me precizion të lartë, me rreze të gjatë” si dhe dronë. Frika për rreziqet e sigurisë për

centralin bërthamor ka qenë konstante që nga fillimi i pushtimit rus. Të dyja palët e kanë akuzuar rregullisht njëra-tjetrën se kanë vënë në rrezik sigurinë e uzinës.

Kina ia anulon vizitën Borrellit



BRUKSEL, 5 KORRIK - Kina ia ka anuluar vizitën shefit të politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, tha një zëdhënese e bllokut evropian.

Borrelli kishte planifikuar ta vizitonte Kinën javën e ardhshme.

Nuk është treguar arsyeja e anulimit të vizitës, që vjen në kohën kur Evropa po synon t'i ulë rreziqet e krijuara nga raporti i ngushtë ekonomik me Kinën, që Brukseli e cilëson si “konkurrenca ekonomike dhe rivale sistematike”.

“Fatkeqësisht, jemi informuar nga homologët kinezë se datat e parashikuara për javën e ardhshme nuk janë të mundshme dhe tani ne duhet të shikojmë alternativa”, tha zëdhënësja e BE-së, Nabila Massrali, në një përgjigje dërguar “Reuters”-it.

Një zëdhënës i Ministrisë së Jashtme kineze nuk ka treguar se pse është anuluar vizita e Borrellit, por nuk e përjashtoi mundësinë që shefi i diplomacisë së bllokut evropian ta vizitonte shtetin në të ardhmen. “Ne e

mirëpresim përfaqësuesin e lartë Borrell në vizitën në Kinë në momentin më të përshtatshëm për të dyja palët”, tha zëdhënësi Wang Wenbin për gazetarët në Pekin. Borrelli kishte planifikuar të takohej me homologun e tij kinez për të diskutuar për “çështje strategjike”, përfshirë të drejtat e njeriut dhe luftën e Rusisë kundër Ukrainës. Kjo është hera e dytë që Borrellit i anulohet vizita në Kinë. Në prill ai nuk mundi të shkojë në Pekin pasi rezultoi pozitiv me koronavirus.

Eurodeputetët kërkojnë vendosjen e sanksioneve ndaj Dodikut

SARAJEVË, 5 KORRIK - Deputetët kryesorë të Parlamentit Evropian që merren me rajonin e Ballkanit Perëndimor kanë kërkuar të vendosen sanksione ndaj liderit të Bosnjë-Hercegovinës, Millorad Dodik, për shkak të veprimeve të tij secesioniste që dëmtojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës.

Shefi i Komisionit për Politikë të Jashtme, David McAllister, raportuesi për Bosnjë-Hercegovinën, Paulo Rangel, dhe shefi i delegacionit për Kosovën dhe BeH-në, Romeo Franz, nëpërmjet një deklarate të përbashkët kanë kërkuar masa urgjente nga BE-ja ndaj Millorad Dodikut. “Nuk mund të tolerojmë më secesionistët dhe mbështetësit e tyre që në mënyrë sistematike ta rrezikojnë Bosnjë-

Hercegovinën”, thuhet në deklaratën e tyre.

Ata e dënojnë vendimin e Asamblesë së entitetit serb në Bosnjë-Hercegovinë për të mos pranuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese të BeH-së, të cilin vendim e konsiderojnë sulm direkt ndaj rendit kushtetues dhe ndaj marrëveshjes së Dejtonit. “Në dritën e provokimeve të fundit të presidentit Dodik dhe zyrtarëve të tjerë udhëheqës të Republikës Sërpska, nevojiten urgjentisht veprime shtesë nga Bashkimi Evropian. Parlamenti Evropian vazhdimisht ka kërkuar nga Këshilli që të kalojë nga deklaratat verbale në veprime specifike ndaj atyre që qëllimisht rrezikojnë rendin kushtetues dhe integritetin e Bosnjë-Hercegovinës. Është koha e fundit për BE-në dhe vendet



anëtare që më në fund të vendosin sanksione ndaj Millorad Dodikut, i cili tashmë është i sanksionuar nga ShBA-ja dhe Britania e Madhe”, thuhet në

këtë deklaratë. Ata kanë tërhequr vërejtjen se kredibiliteti i Bashkimit Evropian është në pikëpyetje dhe BE-ja nuk mund më vetëm të kënaqet

me deklarata verbale në mbështetje të veprimeve të përfaqësuesit të lartë në Bosnjë-Hercegovinë, por në mënyrë aktive duhet të ndër marrë masa.

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, SOT VIZITON REPUBLIKËN E KOSOVËS

E paprecedentë, Kurti kushtëzon takimin me Ramën në Prishtinë



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, do ta vizitojë sot (e enjte) Kosovën në kuadër të turit të tij në Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Serbi. Ndonëse kjo vizitë do të ndodhë, mbetet e paqartë nëse Rama do të takohet me kryeministrin Albin Kurti, pasi ky i fundit ka kushtëzuar një takim të tillë me qeverive. Kurti ka thënë se më të rëndësishme e konsideron mbledhjen e përbashkët të dy qeverive. Rama nuk ka dashur ta komentojë deklaratën e Kurtit, duke thënë se për këtë çështje do të flasë në Prishtinë

dakorduara që janë në sirtar dhe t'i zbatojmë një orë e më parë", ka thënë Kurti. Më tutje, Kurti ka thënë se këtë qëndrim ia ka shprehur edhe Ramës, ku parapëlqen takimin e dy qeverive. "Nëse kryeministri Edi Rama insiston në anulimin e mbledhjes së dy qeverive, atëherë unë ngelem te qëndrimi që ia kam dhënë se për takimin e ne të dyve, ne kemi kontakt të drejtpërdrejtë, sepse takohemi shumë shpesh. Nuk lëngon raporti Kosovë - Shqipëri dhe demokracia e paqja e siguria në Ballkan pse nuk takohet kryeministri i Kosovës me atë të Shqipërisë, por për shkak se mbledhjet e dy qeverive tona janë anuluar pa arsye. Unë e konsideroj të arsyeshme një mbledhje të përbashkët të dy qeverive, por jo takime të tjera", ka thënë Kurti.

Rama nuk e komenton deklaratën e Kurtit: Flas në Prishtinë

Përkritazi për këtë çështje kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nuk ka pranuar ta komentojë deklaratën e kryeministrin të Kosovës, Albin Kurti. Rama ka thënë se për këtë çështje do të flasë kur të vijë në Prishtinë. "Nuk kam lidhje me këtë. Jam këtu vetëm për këtë

vendimin e studentëve. Sa i përket vajtes në Prishtinë dhe të gjithë turit, do të flas kur të jetë koha për të folur e që është nesër (e enjte) në Prishtinë", ka thënë Rama. Pavarësisht se Rama nuk ka dashur ta komentojë deklaratën e Kurtit për takimin në Prishtinë, nuk kanë munguar reagimet dhe kritikën e opozitës karshi kryeministrin të Kosovës. Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se refuzimi i Kurtit për t'u takuar me Ramën është marrëzi dhe turp. "Si është e mundur që kryeministri Kurti refuzon takimin me kryeministrin e Shqipërisë?! Si është e mundur?! Kjo është marrëzi. Turp", ka shkruar Çitaku në "Facebook". Ajo ka thënë se Kurti i vendos kushte Ramës për takim, në anën tjetër takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas asnjë kusht. "Vuçiqin e takon pa kushte, e Ramës i vendos kushte. Kryeministër, Kosova nuk është lodër. Qeverisja nuk është lojë fëmijësh. Lëri inatet, mllfet e hatërmbetjet personale", ka shkruar Çitaku. Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është i mirëpritur në Kosovë. "Natyrisht që kryeministri

i Shqipërisë është i mirëpritur në Kosovë. Fakti që ne e diskutojmë priten ose jo të tij tregon shumë për gjendjen në të cilën ka ardhur Kosova. Kryeministri është i mirëseardhur gjithmonë në Kosovë", ka thënë Abdixhiku. Vizita e Ramës në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Serbi ka të bëjë me përgatitjet që Shqipëria është duke i bërë për samitin e Procesit të Berlinit, i cili do të mbahet këtë vit në Tiranë. Krahas liderëve ballkanikë, në këtë samit do të marrin pjesë edhe ata të Bashkimit Evropian. Procesi i Berlinit është vendosur në vitin 2014 me iniciativën e ish-kancelares gjermane Angela Merkel, me qëllim të lidhjes dhe integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor përpara se të anëtarësohen në Bashkimin Evropian. Procesi i Berlinit shërben si një platformë për bashkëpunimin e nivelit të lartë ndërmjet përfaqësuesve zyrtarë të nivelit të lartë të së ashtuquajturës gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor, e cila përbëhet nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Procesi përfshin edhe institucionet e BE-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në rajon.

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, sot (e enjte) do ta nisë turin e tij në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku do të takohet me përfaqësuesit e Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Serbisë, ndërsa mbetet e paqartë nëse do të ketë takime me drejtuesit e institucioneve të Kosovës, veçanërisht me kryeministrin Albin Kurti, i cili ka refuzuar një takim të tillë. Ndonëse Rama ka bërë me dije se të enjten do të qëndrojë në Prishtinë, kryeministri Kurti një ditë më parë në një konferencë për medie ka thënë se më të rëndësishme e konsideron mbledhjen e përbashkët të dy qeverive për nënshkrimin e

marrëveshjeve të lëna përgjysmë pas anulimit të mbledhjes së 14 qershorit, dhe jo takime të tjera. "Jam në kontakt të drejtpërdrejt me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. E di që do të vijë në një vizitë në Prishtinë në kuadër të turit ballkanik. Miqësisht i kam kërkuar që meqenëse do të vijë, ta mbajmë edhe mbledhjen të dy qeverive e cila u anulua pa arsye, ndonëse ishte parashikuar më 14 qershor në Gjakovë. 13 marrëveshje do të duhet të nënshkruhenin të cilat tashmë kanë ngelur në sirtar. Në mënyrë që këto marrëveshje të nënshkruhen, unë i kam propozuar kryeministrin Rama që meqë po vjen këtë javë, le ta mbajmë edhe një mbledhje të përbashkët të dy qeverive tona, t'i nënshkruajmë ato marrëveshje të



Lajçaku në Prishtinë dhe Beograd për uljen e tensioneve në veri, palët nuk lëvizin nga pozicionet

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për bisedimet Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, të martën dhe të mërkurën ka takuar në Prishtinë dhe në Beograd përfaqësuesit e dy palëve në dialog. Pas takimit me kryeministrin Albin Kurti, ai ka thënë se ka mirëkuptim për t'i çuar përpara kërkesat e Bashkimit Evropian për shtensionimin e situatës në veri, por se “ende duhet të vazhdojnë diskutimet për hapa konkretë”

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 5 korrik - Mosarritja e uljes së tensioneve në veri të Kosovës vazhdon t'i mbajë peng raportet e Qeverisë së Kosovës me partnerët perëndimorë, BE-në dhe ShBA-në.

Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje të dyja palëve, Kosovës dhe Serbisë, t'i ulin tensionet. Kjo thirrje u përsërit të martën dhe të mërkurën në Prishtinë dhe Beograd nga vizita që pati i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se organizimi i zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të Kosovës është mënyra e vetme për ndërrimin e pushtetit lokal në

këto komuna të banuara me shumicë serbe. Ai ka thënë se është dakord për mbajtjen e zgjedhjeve, por shtoi se duhet të bëhen përgatitje që të ketë një fushatë fer e të hapur “në mënyrë që të mos ketë kërcënime dhe në fund bojkot sërish e dalje të ulët”. “Ndërrimi i pushtetit nuk mund të bëhet me dhunë, nuk mund të bëhet duke plagosur ushtarë të NATO-s, policë të Kosovës apo gazetarë, por vetëm me zgjedhje të parakohshme. Dhe, për këtë, neni 72 për vetëqeverisje lokale e shpjegon shumë qartë se si duhet të fillohet me mbledhjen e 20-përqindëshit të elektoratit të gjithëmbarshtëm si nënshkrime të një peticioni që e nis procesin për ato zgjedhje të parakohshme”, ka deklaruar Kurti në një konferencë për

medie pas mbledhjes së qeverisë të mbajtur të mërkurën.

Kurti hodhi poshtë pretendimet se nuk po arrihet shtensionimi i situatës dhe normalizimi i raporteve me Serbinë pasi nuk ka një marrëveshje. Ai tha se marrëveshja drejt normalizimit, të cilën palët e kanë nënshkruar në shkurt në Bruksel dhe aneksin e saj në Ohër një muaj më pas, ekziston dhe se ajo duhet të zbatohet në tërësi. “Unë kam kërkuar dje që gjithçka që është në Marrëveshjen Bazë të figurojë edhe në sekuencën e zbatimit. Pra, të mos kemi diçka që e lëmë anash”, është shprehur Kurti, duke shtuar se këtë kërkesë e ka bërë gjatë takimit që të martën zhvilloi në Prishtinë me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi,

Miroslav Lajçak.

Kryeministri foli edhe për tri kërkesat që BE-ja ia ka parashtruar atij për uljen e tensioneve në veri të Kosovës. “Për këto tri pika unë praktikisht u kam thënë që në masë të konsiderueshme qeveria ka shprehur gatishmërinë sepse për zgjedhjet e parakohshme ne jemi dakord dhe zgjedhjet e parakohshme e rregullojnë edhe çështjen e kryetarit në komunën e Leposaviqit sepse me zgjedhje largohet kryetari”, ka thënë ai. Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, më 22 qershor ka paraqitur kërkesat e bllokut evropian për Kosovën dhe Serbinë lidhur me shtensionimin e situatës në veri: Kosovës i kërkohet që menjëherë t'i pezullojë operacionet policore në afërsi të ndërtesave komunale në veri dhe që katër kryetarët komunalë përkohësisht t'i ushtrojnë detyrat e tyre në objekte alternative; Serbisë i kërkohet të sigurojë që protestuesit të tërhiqen nga ndërtesat

komunale paralelisht me tërheqjen e Policisë së Kosovës; Të dyja shteteve u kërkohet shpallja e zgjedhjeve të parakohshme lokale sa më shpejt që të jetë e mundur në katër komunat në veri të Kosovës, me pjesëmarrjen e pakushtëzuar të serbëve të Kosovës në to.

Që nga fundi i majit serbët po protestojnë në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, duke kundërshtuar që kryetarët e rinj shqiptarë të punojnë nga ndërtesat komunale. Banorët lokalë serbë, po ashtu, po kërkojnë tërheqjen e njësive speciale të Policisë së Kosovës nga afërsia e ndërtesave.

Kurti ka thënë se Qeveria e Kosovës “kursesi nuk kontribuon në përshkallëzimin” e tensioneve në veri. Ai theksoi se duhen përgatitje për zgjedhjet e reja eventuale në mënyrë që në to të marrin pjesë edhe partitë serbe. “Shumë kollaj është të themi zgjedhje të parakohshme dhe unë jam për to, mirëpo në anën tjetër nëse nuk ke asnjë gram garanci që në zgjedhjet e

Ministria e Jashtme do të organizojë aktivitete për diasporën gjatë pushimeve në Kosovë

PRISHTINË, 5 KORRIK - Në mbledhjen e 149 të qeverisë, kryeministri Albin Kurti ka folur për diasporën. Ai u ka uruar mirëseardhje mërgimtarëve në vendlindje, duke theksuar se rikthimi i tyre në atdhe, në shtëpitë e tyre në Kosovë, shënon një moment të veçantë për të gjithë ne, pasi shpreh lidhjen e përvetshme e cila tejkalon kufijtë dhe kohën. “Edhe këtë vit lë të përjetojmë së bashku bukuritë e natyrës dhe trashëgimisë sonë kulturore. Le t'i lidhim gjeneratat e reja me tokën e tyre e le të mësojmë prej më të moshuarve. Në gjuhën tonë qëndrojnë mrekullisht dy fjalë për vendlindjen: mëmëdheu e atdheu, toka e nënës dhe e babait. Prandaj edhe lidhja juaj me Kosovën është shumë e thellë. Në këtë drejtim më lejoni t'ju falënderoj për përkushtimin tuaj për t'i ruajtur traditat tona, rolin

tuaj të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, social dhe politik të Kosovës. Ecja jonë e shpejtë drejt zhvillimit dhe përfundimit të vendit është më e lehtë kur në mendjen tonë e dimë që e kemi mbështetjen tuaj. Prandaj, kontributi juaj ndihet të gjithë sektorët e vendit dhe ne jemi pafundësisht falënderues për angazhimin dhe rolin tuaj të vazhdueshëm për zhvillimin e vendit”, ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se për t'u siguruar që koha e mërgimtarëve në vendlindje do të jetë vërtetë e këndshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka hartuar një listë të gjatë të aktiviteteve të dedikuara veçanërisht për ta, duke përfshirë fushën e sportit, kulturën dhe ndërlidhjen e gjeneratave të reja me vendin e tyre përmes kampesh verore, përvojave kulturore, artistike dhe natyrore.



“Në javën në vijim Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes platformës Shijo Kosovën, do t'ju përcjellë të gjitha udhëzimet dhe informatat

që ndërlidhen me këto aktivitete. Mirë se vini në shtëpi, të dashur bashkatdhetarë! Mirë se vini në vendin tuaj! Le të jetë kjo verë një kohë e bashkimit tonë. Me

kënaqësi ju mirëpresim sërish në Kosovë e mezi presim t'ju takojmë sa më shumë prej jush”, është shprehur kryeministri Kurti në mbledhjen e qeverisë.

ardhshme nuk përsëritet 23 prilli duhet të mendojmë e të përgatitemi më mirë”, ka thënë Kurti.

Në zgjedhjet lokale të 23 prillit nuk morën pjesë partitë serbe dhe votimet u bojkotuan nga popullata serbe. Bashkësia ndërkombëtare i ka kërkuar Serbisë ta sigurojë pjesëmarrjen e serbëve, pa kushte, në zgjedhjet e reja të mundshme në veri. Në të kaluarën Beogradi ka luajtur rol kyç në pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhjet e organizuara në Kosovë.

Lajçaku: Ka mirëkuptim për t'i çuar përpara kërkesat e BE-së

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, ka qëndruar një ditë më parë në Prishtinë, në përpjekje për t'i ulur tensionet në veri të vendit. Lajçaku pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ka mirëkuptim për t'i çuar përpara kërkesat e BE-së, por se “ende duhet t'i vazhdojmë diskutimet për hapa konkretë”.

Ai shtoi se me kryeministrin Kurti i kanë paraqitur pikëpamjet dhe idetë e tyre dhe se “kanë rënë dakord që procesi të vazhdojë”.

Lajçaku nuk ka dashur t'i komentojë masat ndëshkuese që Bashkimi Evropian i ka vendosur ndaj Kosovës, por bëri me dije se BE-ja i ka gati sanksionet edhe për Serbinë. “BE-ja e ka bërë të qartë se i ka sanksionet gati për Serbinë dhe ato do të implementohen nëse vendet anëtare vendosin që Serbia nuk i bindet BE-së. Ky është vendim i shteteve anëtare. Nesër do të jem në Beograd. Dëshira ime është që mos të ketë sanksione për Kosovën dhe Serbinë, por që t'i kemi të dyja palët duke u takuar në Bruksel



dhe të negociojnë se si të implementohet marrëveshja e muajit shkurt [Marrëveshja e Ohrit]”, ka treguar Lajçaku. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës përmes një njoftimi për medie bëri me dije se kryeministri Kurti gjatë këtij takimi ka nënvizuar se masat ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës janë të padrejta dhe e bëjnë dialogun asimetrik. Në njoftim thuhet se kryeministri “ka shprehur përkushtimin dhe angazhimin e tij për shpërshkallëzim dhe normalizim” si dhe se ka theksuar që Qeveria e Kosovës “nuk kontribuon asesi në përshkallëzim dhe se Policia e Kosovës vetëm zbaton ligjin e kujdeset për sigurinë publike”. Në Prishtinë, Lajçaku është takuar edhe me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. Përmes një komunikate për medie, Presidenca ka njoftuar se gjatë

takimit mes Osmanit dhe Lajçakut u diskutua për tejkallimin e “sfidave aktuale politike dhe të sigurisë”. “Institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që së bashku me partnerët ndërkombëtarë t'i tejkalojnë sfidat aktuale dhe se Kosova ka demonstruar vullnet për deeskalim, duke ofruar organizimin e zgjedhjeve të reja në veri të vendit, në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës”, citohet të ketë thënë Osmani. Komunikata thotë se presidentja gjithashtu ka theksuar se “grupet kriminale dhe individët që përdorin dhunë ndaj policisë, gazetarëve, pjesëtarëve të KFOR-it, EULEX-it dhe qytetarëve, duhet të përballen me drejtësinë” dhe se Kosova mbetet “e palëkundur në synimin e saj për paqe dhe stabilitet në vend dhe rajon”. Lajçaku të mërkurën ka shkuar në Serbi, në tentim për t'i bindur

palët që, përveçse ta shtensionojnë situatën, t'i kthehen edhe tryezës së dialogut. Vuçiqi ka njoftuar përmes një postimi në “Instagram” se me emisin evropian ka biseduar për situatën në Kosovë për mënyrat se si të ulen tensionet në terren dhe për zbatimin e marrëveshjeve të arritura deri më tani në kuadër të dialogut që ndërmjetësohet nga BE-ja. “I kam bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar që të angazhohet në mënyrë më konkrete për të gjitha këto çështje”, ka shkruar Vuçiq. Njohësi i proceseve politike, Rrahman Paçarizi, profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, vlerëson se kërkesat e BE-së ndaj palëve nuk janë të pazgjidhshme në rast se palët nuk e kanë për qëllim konfliktin e hapur. “Tani jemi në një situatë ku

asnjëra palë nuk po arrin të vendosë ta bëjë hapin e parë për t'u tërhequr. Mendoj që pala përfutuese do të jetë ajo që do ta bëjë hapin e parë për t'u tërhequr, pasi që do t'ia lërë të gjithë përgjegjësinë, por edhe fajin, palës tjetër nëse nuk vepron njëjtë”, ka thënë Paçarizi për “Radion Evropa e Lirë”. Profesor Paçarizi vlerëson se mungesa e vullnetit nga palët për të bërë hapin e parë për uljen e tensioneve në veri, gjenezën e ka të mungesa e gatishmërisë së tyre për të marrë përgjegjësitë që u takojnë në rast të një marrëveshjeje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Unë mendoj se ngecja kryesore është te mungesa e vullnetit të mirë për ta shtendosur situatën dhe për të shkruar drejt dialogut dhe zgjidhjes përfundimtare. Kjo për faktin se Serbia do të detyrohet ta njohë de-facto pavarësinë e Kosovës, ndërkohë që Kosova do të duhet ta formojë Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Mendoj se këtu ka ngecur 'sharra në gozhdë’”, thotë Paçarizi.

Si shkak i situatës në veri, Bashkimi Evropian ka vendosur masa ndëshkuese për Kosovën. Ato përfshijnë: suspendimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave bilaterale, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Masat e tjera përfshijnë ndaljen e programimit të fondeve për Kosovën nga IPA 2024 (Instrumentet e Para-Anëtarësisimit). Propozimet e Kosovës në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor nuk janë dorëzuar për shqyrtim nga bordi më 29 dhe 30 qershor.

Komuna e Vushtrrisë ofron shërbime për diasporën edhe të shtunën

VUSHTRRI, 5 KORRIK - Komuna e Vushtrrisë deri më 31 gusht do të ofrojë shërbime për diasporën edhe ditën e shtunë.

Kryetari i kësaj komune, Ferit Idrizi, ka njoftuar se enkas për diasporën janë krijuar sportele të veçanta që do të

ofrojnë shërbime në ditët e punës, ndërkaq çdo të shtunë nga ora 10:00 deri në orën 14:00 do të punojnë shtatë zyrtarë në Zyrën e Gjendjes Civile dhe në Qendrën për Shërbim me Qytetarë. “Këtë vendim e kam marrë me qëllim që bashkatdhetarët

nga diaspora të mund t'i kryejnë të gjitha shërbimet për të cilat kanë nevojë në administratën e komunës”, ka thënë ai.

Edhe vitin e kaluar komuna e Vushtrrisë ka punuar ditën e shtunë për të ofruar shërbime për diasporën.



Rahimaj mban dëgjimin përfundimtar për projektbuxhetin për vitin 2024 në Kamenicë



RAHOVEC, 5 KORRIK - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka mbajtur dëgjim me qytetarët për projektbuxhetin për vitin 2024. Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, nënkryetarja për Komunitete, Aleksandra Jovanovic, zyrtari kryesor financiar Naser Hashani, zyrtarë të tjerë komunalë përgjegjës për

mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, qytetarë të komunës së Kamenicës, medie, OJQ dhe të tjerë.

I pari i komunës, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje jo vetëm në këtë dëgjim, por edhe në dëgjimet e tjera, theksoi se këtë vit është rritur numri i dëgjimeve në mënyrë që të trajtohen edhe më shumë kërkesa të qytetarëve. “Faleminderit drejtoreshë dhe të gjithë këtij ekipi komunal që ka qëndruar afër banorëve në

secilin lokalitet në 27 dëgjime buxhetore që kanë pasur për qëllim shpalosjen e projekteve për vitin 2024. Dua t'ju falënderoj të gjithëve që keni ardhur në numër kaq të madh që t'i diskutojmë të gjitha ato që juve ju shqetësojnë. Jemi të hapur për kritika në raport me obligimet që na takojnë në mënyrë që të ndikojmë në mirëqenien e qytetarëve. 27 dëgjime buxhetore. Në krahasim me vitin e kaluar, kemi 7 më shumë, edhe pse

vitin e kaluar kemi qenë komuna e parë më me së shumti dëgjime, por me rritjen e numrit është rritur pjesëmarrja nga gratë dhe burrat, po ashtu janë rritur edhe kërkesat”, ka thënë ai.

Kryetari Rahimaj ka theksuar se jo të gjitha sfidat zgjidhen brenda një viti por, sipas tij, do të punohet që ato nevoja që janë më me prioritet të trajtohen së pari. Qytetarët e Kamenicës në takim kanë paraqitur kërkesat e tyre të cilat

ishin të ndryshme si: asfaltim të rrugëve, shtrim të rrugëve fushore me zhavor, kanalizim, vend për mbeturina të ngurta, ujë të pijshëm, kanalizim, zgjidhje për qentë endacakë, rregullim të trotuareve nëpër lagje, përfundim të punimeve në shesh, vendosjen e shtatores së veprimtarit Metush Krasniqi, rregullim të kanaleve atmosferike, renovim të banesave kolektive, zgjerim të urave, dhe kërkesa të tjera që janë shënuar në procesverbal.



Vazhdojnë punimet për ndërtimin e QKMF-së së re në ish-kampin e KFOR-it në Prizren

PRIZREN, 5 KORRIK - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se janë duke vazhduar punimet drejt finalizimit të projektit të ndërtimit të QKMF-së së re, në ambientet e ish-kampit të KFOR-it (Innovation and

Training Park - ITP) me rreth 1 500 metra katrorë hapësirë për ofrimin e shërbimeve mjekësore, si dhe hapësirë të mjaftueshme parkimi për pacientët. Sipas njoftimit të komunës, ky projekt

planifikohet të përfundojë vitin e ardhshëm dhe pritet të jetë modern si në aspektin infrastrukturor, po ashtu edhe në atë të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Prizrenit.

Bulliçi dhe Krasniqi nënshkruajnë memorandum për ndërtimin e mureve mbrojtëse të lumit Llap dhe Dumnica

PODUJEVË, 5 KORRIK - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliçi dhe ministri i Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimin për zgjerimin dhe rregullimin e shtratit të lumit Llap dhe Dumnica me mure

mbrojtëse (gabionë) në vlerë prej 157 mijë eurosh.

Në këtë projekt komuna e Podujevës participon me 72 mijë euro, kurse Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal me 85 mijë euro. Kryetari Bulliçi e ka falënderuar ministrin Krasniqi dhe Qeverinë e

Kosovës për ndihmën e ofruar për realizimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për qytetarët llapjanë. Pjesë e ceremonisë së nënshkrimit të këtij memorandumit ishte edhe drejtori i Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Bahri Selimi.



Elvir Azizi emërohet drejtor i ri i ShSKUK-së

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i është bashkangjitur mbledhjes së Bordit Drejtues të ShSKUK-së, në të cilën është bërë pranimi i detyrës së drejtorit të ri të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Elvir Azizi. Me këtë rast, ministri e ka falënderuar zëvendësuesen e drejtorit të ShSKUK-së, Narqize Arënliu-Hoxhaj, për punën dhe kontributin e deritanishëm në menaxhim të ShSKUK-së. Ai u shpreh se drejtoresha ka bërë

punë të jashtëzakonshme gjatë kohës sa përkohësisht e ka menaxhuar ShSKUK, përkundër sfidave. Ministri Vitia, pasi ka uruar zgjedhjen e drejtorit të ri të ShSKUK-së, ka shtuar se përkrahja e Ministrisë së Shëndetësisë do të jetë e vazhdueshme për Bordin Drejtues dhe drejtorin e ri. Në anën tjetër, Arënliu Hoxhaj ka njoftuar për punën dhe projektet që janë zhvilluar gjatë kohës sa e ka menaxhuar ShSKUK-në, por edhe

projektet që janë në zbatim e sipër. Elvir Azizi, drejtor i ShSKUK-së, ka falënderuar ministrin dhe Bordin për besimin që i është dhënë për menaxhim të ShSKUK-së, duke premtuar angazhim maksimal për avancim të projekteve në të mirë të shërbimeve shëndetësore për pacientët. Elvir Azizi është zgjedhur drejtor i ShSKUK-së përmes konkursit publik që kishte shpallur Bordi Drejtues i ShSKUK-së.



Ekspertët nga Turqia mbështetin fuqizimin e shërbimit për Stroke në Kosovë

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka marrë pjesë të mërkurën në punëtorinë e organizuar në QKUK-ja si vazhdimësi e ngritjes dhe zgjerimit të shërbimit Stroke në Kosovë. Në këtë punëtori morën pjesë drejtoresha e Klinikës së Radiologjisë, Shkëndije Nuza, prof. Serdar Geyik, neuroradiolog intervent dhe prof. dr. Arsida Bajram, neurolog intervent nga Spitali Universitar Aydin në Stamboll. Ministri Vitia i ka falënderuar profesorët nga Turqia për mbështetjen dhe përgatitjen e profesionistëve shëndetësorë të Kosovës për këtë shërbim. "Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK-ja shprehin gatishmërinë dhe

rëndësinë për funksionalizimin e shërbimit për Stroke si shërbim i domosdoshëm", ka deklaruar Vitia. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte vazhdimësia e mbështetjes për përgatitjen e stafit, mbështetjen e implementimit dhe organizimin e shërbimit për Stroke në Kosovë. Aktualisht në Spitalin Universitar Aydin janë duke u trajnuar dy neuroradiologë intervenoë nga Klinika e Radiologjisë. Pas trajnimit të këtyre mjekëve pritet të rritet numri i neuroradiologëve intervenoë. Kjo punëtori është mbështetur nga ekspertët e Spitalit Universitar Aydin në Stamboll, një ndër qendrat e Stroke më eminente në Evropë.



MAPL-ja i shpall të pavlefshme vendimet e pozitës për ndërmarrjet publike në Prishtinë

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) i ka shpallur të pavlefshme vendimet që Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike i kanë ndërmarrë në mbledhjen e fundit të Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Dy partitë në pushtet në këtë mbledhje kanë siguruar votat e mjaftueshme për ta shkarkuar kryesuesin e Kuvendit Komunal, Fehmi Kupinën, si dhe për t'i rikthyer anëtarët e



vet në bordet e ndërmarrjeve publike. Sipas konstatimit të MAPL-së, në një vlerësim të ligjshmërisë,

mbledhja V e kryeqytetit "ka përfunduar në atë moment kur kryesuesi i Kuvendit e ka shpallur të mbyllur mbledhjen

për shkak të rrethanave të krijuara në pamundësi për të vazhduar, andaj vazhdimi i mbledhjes dhe vendimet e miratuara në atë mbledhje nuk krijojnë asnjë efekt juridik". Vendimin e ministrisë e ka publikuar të mërkurën në "Facebook" asamblisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Gëzim Sveçla, i cili ka thënë se është momenti i fundit që të publikohen vendimet e seancës së jashtëzakonshme të datës 8 qershor, të miratuara nga

opozita. "Anullohet seanca klandestine e partive në pushtet në Prishtinë. Aksionarët e ndërmarrjeve publike komunale mbeten ata që kanë qenë, të opozitës. Kryesuesi mbetet ai që ka qenë nga fillimi i mandatit. Të gjitha vendimet e tjera që janë marrë në atë 'seancë' janë të pavlefshme. Është momenti i fundit të publikohen vendimet e seancës së jashtëzakonshme të datës 8 qershor. Mjaft e shkelët ligjin!", ka shkruar ai.

Përparime të reja në bashkëpunimin universitar Kosovë - Holandë

PRISHTINË, 5 KORRIK - Punëtorja shkencore për diasporën u mbajt në Ambasadën e Kosovës në Holandë. Pjesëmarrës ishin studiues nga diaspora, përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës, zyrtarë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe

Inovacionit. Prorektori Avdiaj ishte përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës. Ai pati mundësinë t'i bashkërendojë nismat për avancim ndërkombëtar. Së bashku me ambasadorin e Kosovës në Holandë, Dren Doli, prorektori Sefer Avdiaj u takua me profesorin e asociuar të Universitetit të Matrihtit, Fabian Raimondo.

Ata u mbledhën në ambientet e Ambasadës së Kosovës në Holandë për të diskutuar rreth krijimit të kursit të Drejtësisë Tranzicionale në Kursin Ndërkombëtar Veror të Prishtinës. Iniciativa të tilla përfaqësojnë përpjekjet e Universitetit të Prishtinës për të ofruar kurse në fushën e të drejtave të njeriut në përgjithësi.



AAK-ja: Qeveria Kurti e ka rënduar shumë jetën e qytetarëve, vazhdon mashtrimet

PRISHTINË, 5 KORRIK - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se qeveria Kurti ua ka rënduar jetën qytetarëve. Reagimi i Tahirit vjen pas konferencës së kryeministrit Albin Kurti me ministrin e Financave, Hekuran Murati, duke shtuar se këta po vazhdojnë mashtrimet. "Më la shumë përshtypje një mashtrim

skandaloz që ua bëri me qytetarëve të Kosovës, ministri Hekuran Murati. Ai kërkonte që sektori privat t'i rritë pagat për punëtorët sepse u është rritur fitimi. Është vetë personi përgjegjës, që e ka në dorë, me një rishikim buxhetor, me një ndërrim të një neni, ta rritë koeficientin nga 105 në 129 euro, siç kemi rekomanduar si AAK dhe t'i rritë pagat në

sektorin publik për 80 mijë njerëz", thuhet në reagimin e Tahirit.

Ai thekson se Murati është një ministër që nuk ka bërë asgjë për sektorin privat. "Është një ministër i Financave që nuk ka bërë asgjë për sektorin privat, për biznesin, për ekonominë, veçse ua ka rënduar jetesën, e veçse ua ka qëndruar mbi kokë tash e dy vjet e gjysmë", ka thënë Tahiri.



Qeveria krijon skemë të re pensionale për të larguarit nga puna në vitet '90



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka miratuar ndryshimet në Ligjin për Pensionet, duke u mundësuar pensionistëve që janë larguar nga puna në vitet '90, të përfitojnë nga pensioni kontributpagues.

Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës u miratuan ndryshimet në Ligjin për Skemat Pensionale të financuara nga shteti, ku u krijua edhe një skemë e re e quajtur skema e pensionit parcial kontributpagues të moshës.

Në këtë skemë do të futen qytetarët që janë larguar nga puna në vitet '90 e të cilëve nuk

u është njohur kontributi dhe, për rrjedhojë, nuk kanë plotësuar kriterin prej 15 vjetësh stazh për të përfitur nga pensioni kontributpagues. Sipas kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, me këto ndryshime të gjithë pensionistët do të trajtohen në mënyrë të barabartë. "Përmes tij [plotësim-ndryshimit të ligjit] do t'i adresojmë çështjet e pabarazisë disavjeçare të mosnjohjes të së drejtës pensionale në skemën kontributpaguesve për një numër të madh të pensionistëve të cilët nuk përmbushin kriterin prej 15 vjetësh kontribut në ish-sistemin pensional. Për ta eliminuar këtë diskriminim për

të gjithë ata që janë larguar dhunshëm nga puna në vitet '90, si qeveri po shtojmë një skemë të re pensionale, skemën e pensionit parcial kontributpagues", tha Kurti. Ndërkaq, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, tha se sipas vlerësimeve aktuale, kjo skemë është përlogaritur se do t'i kushtojë shtetit rreth 60 milionë euro në vit. Ai tha se lartësia e pensionit për skemën e re do të përcaktohet bazuar në vitet që pensionistët kanë kontribuar në Fondin Pensional, i cili është përvetësuar nga Serbia. "Vlerësimet tona janë se aktualisht në skemën e pensionit bazik duhet të jenë rreth 70 000 persona që marrin pension bazë, por që realisht do

të duhej të kualifikoheshin për pensionin parcial kontributpagues të moshës", tha Murati.

Ministri Murati tha se shpreson që pasi këto ndryshime të dërgohen në Kuvend, deputetët do t'i miratojnë shpejt ato. "Me plotësim-ndryshimin e këtij ligji ne po e zhbëjmë këtë diskriminim sepse do t'u mundësohet që për periudhën prej kur janë larguar nga puna e deri më 1 janar 1999, t'u llogaritet drejt plotësimi i kushtit prej 15 vjetësh", tha Murati.

Ndryshime sa i përket kushtit prej 15 vjetësh stazh janë kërkuar që një kohë të gjatë nga sindikatat e punëtorëve. Pensionet në Kosovë sillen nga 100 deri në 265 euro.

Qeveria miraton kodin e ri doganor të Kosovës

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të mërkurën ka miratuar edhe kodin e ri doganor. Kodi doganor dhe i akcizave harmonizohet me legjislacionin evropian dhe përshtatet me zhvillimet e reja në fushën e tregtisë. Ky projekt-kod paraqet kornizë gjithëpërfshirëse për rregullat dhe procedurat doganore në territorin doganor të Republikës së Kosovës.

Murati kërkon nga bizneset t'i rritin pagat e punëtorëve

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka kërkuar që bizneset duhet t'i rritin pagat e punëtorëve. Murati në një konferencë për medie është shprehur se marzha e fitimit për shumë biznese është rritur dukshëm vitet e fundit. "Kemi problemin e mosfrimit të kushteve të

punës nga ana e bizneseve, duke filluar që nga pagesat. Për shumë biznese marzha e profitit është rritur, sidomos vitet e fundit. Këtë e them nga të dhënat e konfirmuara, prandaj duhet të rriten edhe pagat e punëtorëve", ka thënë Murati. Ai ka shtuar se nga masat mbështetëse të qeverisë për

ritjen e pagave, deri më tani kanë përfitur rreth 17 mijë punëtorë. "Ne si qeveri i kemi bërë disa herë thirrje, kemi pasur masa mbështetëse edhe për ritjen e pagave, ku kanë përfitur rreth 17 mijë punëtorë edhe përmes platformës Super Puna", përfundoi ai.



Më lejuat të shoh çfarë bëhet për të ardhmen, në një vend ku e shkuara mund ta kishte vrarë



Nga Bill CLINTON

Jam pa fjalë dhe nëse do të kisha gjykim të mirë nuk do të thoja asgjë. Jam vërtetë pa fjalë. Kryeministër, ministra e zyrtarë të tjerë, i gjithë populli shqiptar që është pjesë, dua t'ju falenderoj për një moment që do ta ruaj si thesar gjithë jetën time. Ka më shumë se 10 vjet që kur bashkëshortja ime erdhi këtu si sekretare e shtetit. Gjithmonë e pyesja si po ndihej sepse gjithmonë doja të vija. Ndjej se edhe pse jam një qytetar privat pa asnjë pushtet publik mund të flas për këtë çështje në emër të popullit amerikan. Lidhur me këtë, për partitë tona politike, dallimet filozofike, kundërshtive fetare, pavarësisht, ne jemi të angazhuar për lirinë, forcën dhe integritetin e Shqipërisë. Jam shumë mirënjohës për atë që kryeministri tha për Kosovën. Unë dhe Hilary jetojnë në New York që është vendi me më shumë shqiptarë në Amerikë, nuk e ci rrugës pa i parë. Para se të largohesha po ecja dhe kalova para tre restoranteve të shkëlqyera shqiptare dhe njerëzit më tregonin për axhendën këtu. Dua të them faleminderit kryeministrit për fjalët e tij për politikën time dhe qasjen e rrugës së tretë që Tony dhe unë u përpoqëm ta



ndiqnim. Jam shumë i nderuar që edhe dhëndri im është këtu me mua sot. Gjëa e fundit që ndodhi para se të vinte këtu ishte që Chelsea na nxorri tre fëmijët e tyre në telefon dhe na kujtoi qëllimin e gjithë kësaj. Kur dëgjoj kaq shumë nga këto gjëra që thuhet sot në mbarë botën. Që kanë synim të na përçajmë, të na bëjnë të kemi frikë nga njëri-tjetri, një trajtim i padrejtë. Kur e pashë të ndodhte në Kosovë e në Bosnje ato vite më parë kur isha president, e pashë të ndodhte si djalë i ri në vendlindjen time. Për fëmijët që u mohojmë e drejta për të shkaur në shkollë për shkak të racës së tyre. Kurrë nuk ka pasur lidhje me të vërtetën por është bërë për të fituar pushtet, dominim dhe kontroll pa asnjë llogaridhënje nga ata njerëz që shtyjnë kufijtë duke menduar se janë krijuar të epërm nga Zoti. Pë rata prej jush që shërbejnë në qeveri, për rrinë e jashtëzakonshme, për praninë e grave në Qeveri, për të rinjtë mbreslënës që folën të cilët mbajnë emrin tim, u kërkoi të mos shkurajoheni sepse këto probleme i kanë rrënjët te një impuls që është më i vjetër se shtetet kombe, më i lashtë se edhe besimet fetare. Ka patur gjithmonë një frikë se në momentin që do të shkojmë përtej llojit tonë, diçka e keq

mund të ndodhë. Shihni këta fëmijë, gëzimi më i madh në jetë ndodh kur ne hapemi ndaj mundësisë që çdo person mund të marrë. Edhe një herë, e kam të vështirë të flas. Mësimi thelbësor i jetës sime në politike nuk janë ato që mësova në universitet apo në valën e zgjedhjeve apo në sallonet e diskutimeve të qeverisë por i kam mësuar kur isha një djalë i vogël që rritesha duke parë njerëzit të jetonin jetën e tyre. Fjala dhe nderi kishte një vlerë konstante për këdo. Mendoj se është e rëndësishme që të pranojmë se dallimet tona kanë rëndësi sepse askush nuk ka të drejtë gjithmonë. Duhet të jemi të lirë, të dëgjojmë njëri-tjetrin. Duhet të mos harrojmë se e vetmja mënyrë që të gjithë të kenë zërin e tyre është të themi fort dhe qartë se të qenit njerëz vlen më shumë. I kam parë këto 30 vitet e fundit në Shqipëri, i mrekulluar sepse kur isha i ri në universitet dhe studioja luftën e ftohte dhe botën komuniste dhe shihja Shqipërinë në hartë si një vend i mbyllur e mister. Kur isha 18 vjeç i thoja vetes, a do të shkoj ndonjëherë aty? Kurrë nuk ma merrte mendja se do të vija si president, isha thjeshtë një njeri që vija nga një rrugë e gjatë që doja të dija historinë e këtij vendi të mbyllur nga bota. Mendoj që më keni dhënë një

dhuratë mjaft të madhe thjeshtë duke iu thënë përshëndetje e duke më lënë t'ju shoh. Kam jetuar rreth njerëzve që janë përpjekur të ngrenë mure dhe tani kjo kënga që këndohet në mbarë botën për rëndësinë e ndasive mund ta dëgjoj e ta ndjeje e ta shoh edhe kur s'është më. Kjo është më e shkuar në Shqipëri sesa në çdo vend ku kam qenë. Jeni shpërblyer për këtë dhe do të shpërbleheni. Ka një mosmarrëveshje që po ndodh tani në Kosovë, nuk do doja të ndodhte më. Nuk është më vendimi imp or kosovarët i krijuan ato 4 qyteza në të mirë të serbëve për t'u dhënë 4 bashkiakë më tepër dhe mendoj se tani kanë bërë një gabim.² Është me e lehtë që shqiptarët të përfitojnë nga momenti për të paraqitur argumentin e tyre por duhet ndalur kjo marrëzi. Çfarë çështje e madhe politike mund të avancohet duke patur njerëz që jetojnë aty. Qytetarët kanë nevojë të thuhet që i'u duhet të votojnë. Sapo erdha nga Mbretëria e Bashkuar duke kremtuar 25 vjetorin e të premtës së zezë, ata kanë një problem të madh. Kur nisën në Irlandën e Veriut kishin më shumë protestantë irlandezë që donin të mbeteshin pjesë e Mbretërisë së Bashkuar. Ama ishin të gatshëm t'i jepnin zë

edhe kundërshtarëve katolikë irlandezë. U krijua mundësia për një forum që njerëzit të gjenin një mënyrë për të ndarë të ardhmen. Shumë larg nga çdo laborator modern shkencor ku modelohet sjellja përçarëse që po nxit botën sot, kryesisht sepse shumë vende drejtohen nga njerëz që duan përçarje. Unë shpresoj që Shqipëria t'i tregojë botës si ndërtohet një e ardhme gjithëpërfshirëse. Doja që bota të shikonte një video të këtyre fëmijëve. Ju e merni për të mirëqënë por shumë vende do të ishte e çuditshme. Nuk dua të nënvlerësoni fuqinë e shembullit tuaj. Dikur unë një student shkollë që nuk dinte asgjë për Shqipërinë për shkak të një muri, m'u desh të pyesja të shqiptoj emrin e njeriut që drejtonte këtë vend. Tani këtu ndihesh pak më i madh, më inteligjent, më i gatshëm për të qendruar. E dimë që keni ende probleme ekonomike, jeni njerëz, nuk jeni të përsosur por mund të jeni në anën e duhur të historisë. Sot, ju më dhatë një dhuratë të madhe. Më të madhe madje, edhe se sa medalja. Më lejuat të shoh çfarë bëhet për të ardhmen, në një vend ku e shkuara mund ta kishte vrarë.

Pjesë nga fjala e Bill Clinton mbajtur në Tiranë



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova mëson kundërshtarët për kualifikimet në Botëror dhe Evropian

Përfaqësuesja e Hendbollit e Kosovës të mërkurën mësoi se Sllovakia është kundërshtarja e raundit të parë për kualifikueset në Kampionatin Botëror, ndërsa Britaninë e Madhe është kundërshtarja e “dardanëve” në raundin promovues të kualifikimit në Kampionatin Evropian



2025 Men's World Championship Qualification Europe Phase 1	Men's EHF EURO 2026 Promotion Round
Luxembourg vs Israel	Latvia vs Luxembourg
Great Britain vs Finland	Kosovo vs Great Britain
Latvia vs Estonia	Belgium vs Cyprus
Slovakia vs Kosovo	
Türkiye vs Italy	

“Epoka e re”

PRISHTINË, 5 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në Hendboll të mërkurën e ka mësuar emrin e kundërshtarit për fazën e parë kualifikuese për Kampionatin Botëror të vitit 2025. Shorti është tërhequr të mërkurën në Vjenë. “Dardanët” do të përballen me Sllovakinë, ndërsa ndeshjet e raundit të parë kualifikues për Kampionatin Botëror të vitit 2025 zhvillohen më 1/2 dhe 4/5 nëntor.

Sllovakia në ndeshjen e parë është vendëse, ndërsa Kosova në të dytën. Në fazën e parë kualifikuese paraqiten dhjetë kombëtare. Luksemburgu-Izraeli, Britania e Madhe - Finlanda, Letonia - Estonia, Turqia - Italia janë çiftet e tjera. Shorti nuk është i lehtë, por synim mbetet kalimi në fazën e dytë. Përfaqësuesja e Kosovës për meshkuj ka mësuar të mërkurën edhe kundërshtarin e parë në kualifikimet për “Euro 2026”. Në Vjenë janë tërhequr shortet për

dy gara të ndryshme. Kështu Kosova përballen me Britaninë e Madhe në raundin promovues të kualifikimit në Kampionatin Evropian të vitit 2026. Ndeshjet janë në janar të vitit të ardhshëm, ndërsa Përfaqësuesja e Kosovës është nikoqire në ndeshjen e parë. Synimi është të kalohet Britania e Madhe, përkatësisht kalimi në fazën kryesore të kualifikimeve për Evropian. Letonia - Luksemburgu dhe Belgjika - Qipro janë çiftet e tjera të raundit promovues të kualifikimeve për “Euro 2026”.

SHKURT

KB Peja e mëson emrin e kundërshtarit në Ligën e Kampionëve

KB Peja e ka mësuar emrin e kundërshtarit në Ligën e Kampionëve. Në shortin e hedhur në Zvicër, klubi pejan u vu përballë ekipit Bakken Bears në kualifikimet e kësaj gare në basketboll. Kampionia e Kosovës do të mundohet të tregohet e suksesshme ndaj ekipit danez dhe të shkojë sa më larg në Ligën e Kampionëve.

Edicioni i ri në Superligë nis më 12 gusht

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së bëri një rezymë për përfundimit të garave në të gjitha rangjet dhe kategoritë me konstatimin se garat ishin zhvilluar sipas dinamikës së paraparë e që reflektuan me ngritje të cilësisë, shtim në organizim dhe rivalitet sportiv. KE uroi ekipet që arritën të kalojnë një rang më të lartë të garave, ndërsa atyre që u larguan nga ligat u dëshiroi suksese në të ardhmen. KE caktoi datën 31 korrik kur do të hedhet shorti i garave për edicionin 2023/2024, ndërsa edicioni i ri 2023/2024 fillon me garat e Superligës më 12 gusht, ndërsa ato të Ligës së Parë më 19 gusht. Njëkohësisht garat e Ligës U21 nisin njëjtë me garat e Superligës më 12 gusht. KE miratoi edhe Rregulloret e Garave në konkurrencën e meshkujve dhe të femrave.

Prishtina 01 mëson kundërshtarët e grupit në Ligën e Kampionëve

Kampioni i Kosovës në futsall dhe fitues i Kupës së Kosovës, Prishtina 01, ka mësuar tashmë ekipet me të cilat do të përballen në raundin preliminar në Ligën e Kampionëve për sezonin 2023/24. Të mërkurën është hedhur shorti për grupet në raundet preliminare në Ligën e Kampionëve në futsall. Prishtina 01 është shortuar në Grupin D, ku si kundërshtar do t'i ketë KSC Lubawa (Poloni), Utleira Idrettslag (Norvegji) dhe Isbjorninn (Islandë). Ndeshjet e këtij raundi parakualifikues do të zhvillohen nga data 22 deri në 27 gusht në Poloni. Vendi i parë i grupeve do t'u bashkohet ekupeve të tjera me koeficient më të lartë në “main-raund” me ndeshjet që zhvillohen nga 24 deri në 29 tetor. “Main-Round” çon ekipet pastaj në raundin elitare të nëntorit dhe dhjetorit, i cili do të vendosë katër pretendentët për në finalen e eliminimit në maj të vitit të ardhshëm.

Kuka: Japonia e njeh Kosovën përmes xhudos

PEJË, 5 KORRIK - Ambasadori i Kosovës në Japoni, Sabri Kiçmari, të mërkurën e ka vizituar ekipin e xhudo në stërvitje. Trajneri Driton Kuka ka thënë se Japonia e njeh shtetin tonë përmes xhudos dhe heroinave tona që atje janë shumë të njohura. “Në stërvitje mysafir kishim ambasadorin e Kosovës në

Japoni, Sabri Kiçmari dhe mikun tonë, njëherësh njeriun që kishte punuar në Ambasadën e Kosovës në Japoni dhe ishte ai që ekipit tonë i ka ndihmuar gjatë qëndrimeve tona atje, miku im Arber Mehmeti. Që të dy sollën përshëndetjet nga Japonia e largët e me dëshirën e qytetit Sanjo ku ne

ishim para Botërorit dhe Lojërave Olimpikë që me qytetin e Pejës të krijojnë marrëdhënie të veçanta. Japonia, shteti ndër më të fuqishmit në botë, shtetin tonë të ri e njeh përmes xhudos dhe heroinave tona që atje janë shumë të njohura”, ka shkruar Kuka në “Facebook”.



PSG-ja edhe zyrtarisht ndahet me Galtierin

PARIS, 5 KORRIK - Paris Saint-Germain ka njoftuar prishjen e kontratës me konsensus së bashku me trajnerin francez Christophe Galtier, i cili udhëhoqi klubin drejt triumfit në Ligën 1 në

sezonin e fundit. "Në fund të vitit financiar 2022-2023, Paris Saint-Germain dhe Christophe Galtier kanë vendosur t'i japin fund kontratës së tij si trajner i ekipit të parë. Klubi dëshiron ta theksojë

profesionalizmin dhe përkushtimin e tij, i cili i mundësoi Rouge & Bleu ta fitojë titullin historik të njëmbëdhjetë të kampionatit francez, si dhe një Superkupë. Paris Saint-Germain

fitoi titullin e 11-të të Ligës 1 nën komandën e tij, duke u bërë klubi më i madh në historinë e kampionatit francez", thuhet në njoftimin e PSG-së. Pasues i Galtier te Paris Saint-



Germain thuhet se do të vijë spanjollli Luis Enrique.

Zbardhet dëshmia e Alvesit: Kam gënjyer për ta shpëtuar martesën

BARCELONË, 5 KORRIK - Dani Alves vazhdon të jetë në burg prej më shumë se pesë muajsh teksa akuzohet për përdhunim në një nga klubet e qytetit të Barcelonës. Ish-futbollisti ka pasur një histori erotike me një vajzë që ishte në disko, por kjo histori është kthyer në makth për të pas denoncimit për përdhunim. Mediet spanjolle kanë zbuluar edhe dëshminë që Dani Alves ka dhënë për këtë ngjarje. Në fillim ai shprehej se nuk kishte ndodhur kurrë asgjë, por më pas e ka përgënjeshtuar këtë deklaratë duke u shprehur se donte vetëm që ta shpëtonte martesën. "Pasi hymë në tualet, qëndruam ballë për ballë dhe ajo nisi të më puthte dhe të më hiqte pantallonat. Nuk ka ndodhur asgjë që ne nuk e donim. Gjithmonë e kam trajtuar me respekt të madh. Ne ishim të ulur në tavolinën që ishte në hyrje. Fola me Brunon dhe i bëmë me shenjë kamerierit dhe ai menjëherë na solli tri vajza. Po



argëtoheshim dhe me njëren prej tyre kishim menjëherë një tërheqje seksuale. Ajo më uli në tualet dhe menjëherë filloi të më ngacmonte. E kam pyetur dy herë nëse i pëlqente diçka e tillë dhe më ka

thënë po. Më pas ajo u çua dhe u kthye me kuriz nga unë dhe aty kemi kryer marrëdhënie. As në tualet dhe as në dhomën private nuk më ka kërkuar që të ndaloj për asgjë", ka deklaruar Alves.

Leclerc: Më në fund era është në favorin e Ferrarit

MARANELLO, 5 KORRIK - Ferrari arriti dy vende të dyta fundjavën e kaluar në Austri, me Carlos Sainz në garën sprint të së shtunës dhe me Charles Leclerc në garën e së dielës. Rezultat ky që motivon mjaft skuadrën italiane, që këtë sezon nuk ka fituar ende asnjë garë. Mjaft i kënaqur duket Leclerc, që në Austri u paraqit mirë si në provat zyrtare ashtu dhe në garë. "Do ta preferoja fitoren, por edhe vendi i dytë shkon mirë. E rëndësishme është që përmirësimet që kishim sjellë këtu shkuan mirë. Mësuam shumë dhe do të përpiqemi të bëjmë një hap tjetër përpara në garën e Silverstones. Po dalim nga tuneli dhe skuadra e ndien këtë gjë, që era më në fund po fryn në favorin tonë", ka thënë Leclerc. "Ne japim maksimumin në pistë, teknikët e inxhinierët në fabrikë dhe jemi të kënaqur. Do të përpiqemi që të rikthehemi te fitorja sa më shpejt, por jemi realistë dhe e dimë se Red Bulli është ende para nesh. Në Austri s'mund të shkonim më



shumë se vendi i dytë", ka deklaruar Leclerc, që e kryesoi garën edhe për 10 xhiro. Gjithsesi, monogasku qëndron me këmbë në tokë: "Është shpejt për të thënë se tani jemi forca e dytë në

kampionat. McLaren këtu ishte i shpejtë, ndërsa Aston Martin e Mercedesi vuajtën disi. Duhet parë edhe 2-3 gara për ta parë realisht vendin tonë mes skuadrave të tjera".

SHKURT

Mount, lojtar i ri i Unitedit

Mason Mount edhe zyrtarisht është lojtar i ri i Manchester Unitedit. Ky transferim i kushtoi Unitedit rreth 65 milionë euro. "Djajtë e Kuq" e transferuan mesfushorin anglez nga Chelsea, ndërsa lojtari ka nënshkruar kontratë me klubin nga "Old Trafford" deri në vitin 2028, me mundësi vazhdimi për një vit tjetër në rast se merren vesh palët. 24-vjeçari i ka zhvilluar 279 ndeshje në nivelin e klubeve, duke i realizuar 58 gola dhe i ka bërë 53 asistime. Përfaqësuesi anglez e ka fituar Ligën e Kampionëve me "Blues", ndërsa ishte zgjedhur lojtari i vitit në sezonet 2020/21 e 2021/22 në "Stamford Bridge". Futbollisti kreativ i ka zhvilluar 36 ndeshje me Kombëtaren e Anglisë, ndërsa luajti rol të rëndësishëm në shkuarjen deri në finale të "Euro 2020".

Barça përforcohet me Martinezin

Inigo Martinez është lojtari më i ri i Barcelonës. Këtë e ka konfirmuar gazetari italian Fabrizioo Romano, duke theksuar se gjithçka ka përfunduar. Martinezin bashkohet me Barcelonën pas Gundogan si një transferim me parametra zero. Qendërmbrojtësi spanjoll do të ketë një kontratë dyvjeçare me katalanasit dhe klauzola e tij e lirimimit do të jetë 400 milionë euro.

Di Maria rikthehet te Benfica

Angel Di Maria është rikthyer në Benficë. Ylli argentinasi i dha fund përvojën në Juventus për t'u rikthyer në Portugal, aty ku nisi ngritja e tij si futbollist. Veterani ofensivë ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me klubin portugez deri në verën e vitit 2024, njofton eksperti i transferimeve, Fabrizioo Romano. Di Maria e pati një përvojë të shkëlqyeshme në Real Madrid, për të luajtur më pas edhe në Manchester United e në Paris Saint-Germain para se të përfundonte në Juventus. Ai konsiderohet një prej futbollistëve më të mirë në botë në dekadën e fundit në pozitën e tij.

PSG-ja e sheh Kolo Muanin zëvendësues të Mbappes

PSG-ja është duke kërkuar një zëvendësues për Kylian Mbappe, i cili mund të largohet nga Liga 1. Lojtari i Eintracht Frankfurtit, Randal Kolo Muani, po shihet si pasardhës i Mbappes. "Bild" raporton se PSG-ja ka nisur bisedimet me Muanin, i cili kërkohet edhe nga Bayern Muncheni dhe Manchester Unitedi. Çmimi i reprezentuesit francez nga Frankfurti vlerësohet 90 milionë euro.

Anelotti merr drejtimin e Brazilit në vitin 2024

Carlo Anelotti do të largohet nga Real Madridi sezonin e ardhshëm. Menjëherë pas përfundimit të kontratës së tij në vitin 2024, trajneri

italian do të marrë drejtimin e Brazilit. Lajmin e ka dhënë vetë presidenti i Federatës Braziliene të Futbollit, Ednaldo Rodrigues. Anelotti

do të marrë pozitën e trajnerit të "Selecao" për Kupën e Amerikës në vitin 2024 që do të zhvillohet në ShBA. Deri atëherë

kombëtarja e Brazilit do të drejtohet nga tekniku i përkohshëm Fernando Diniz. Trajneri i Real Madridit do të jetë i huaji i parë që do

ta drejtojë Brazilin pas gati 60 vjetësh. I fundit ishte argentinasi Filpo Nunez i cili i drejtoi brazilianët në vitin 1965.



Në bazë të nenit 8, të Ligjit të Punës nr.03/L-212, NPL "Hortikultura" SH.A vazhdon afatin e shpalljes edhe për 5 (pesë) ditë për këtë konkurs:

KONKURS

Për plotësimin e vendimit të punës

Titulli: Konsulent/e i/e jashtëm/e për projekt në ri-organizimin e njësisë së lulishtes

I rapoorton: Kryeshefit Ekzekutiv

Orët e punës: 40 orë në javë

Kompensimi: 800 euro (bruto) në muaj

Kohëzgjatja e kontratës: për kohë të caktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale:

- shkollim superior në degën e Arkitekturës apo Ndërtimtarisë, Arkitekturë Pejzazhi apo Inxhinieri Mjedisore
- të ketë përvojë në menaxhimin dhe realizimin e projekteve
- njohja e softwareve dhe programeve Archicad, Autocad, Photoshop
- aftësi për punë ekipore
- aftësi të shprehura komunikimi
- të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë.
- e preferuar njohja e gjuhës angleze
- përvojë 5 vjeçare

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- analizon, vlerëson situatën ekzistuese të njësisë së lulishtes
- bën studim fizibiliteti për projektin e propozuar
- bën vlerësimin e paramasës dhe parallogarisë
- jep sygjërimi për gjendjen faktike të terrenit
- koordinon vazhdimisht me njësinë e lulishtes për të identifikuar nevojat
- përcjell vegetacionin e disponueshëm në tërësi dhe propozon në rregullimin e dizajnit-pamjes së vegetacionit, duke përfshirë mbjelljen e luleve, mbjelljen e materialit dendrologjik, krasitjen e drunjeve dekorativ dhe punë të ngjashme në gjelbërim
- analizon praktikatat dhe proceduarat e punës me qëllim të rritjes së efikasitetit si dhe propozon modifikimin apo përshtatjen e tyre sipas nevojës dhe zhvillimit
- përgatit planin e të hyrave dhe shpenzimeve vjetore
- përgatit planet afat-mesme dhe afatgjate të njësisë së lulishtes
- për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv

Procedura e konkurimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes NPL "Hortikultura" apo ta shkarkojnë nga web faqja e internet në adresën www.hortikultura-pr.com.

Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën, rr. Tahir Zajmi, pn në Prishtinë, apo përmes Postës së Kosovës.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikacioni i duhet bashkangjitur:

- formulari për aplikim i NPL "Hortikultura";
- dëshmitë për kualifikimin shkollor;
- dëshmitë për përvojën e punës;
- kopjen e letërnjoftimit
- certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është i/e dënuar (jo më të vjetër se gjashtë muaj)

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë Brenda dy ditësh (2) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

Shpallja është e hapur që nga data 06.07.2023 – 10.07.2023.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të NPL "Hortikultura" SH.A.



Na osnovu Zakona o Radu br.03/L-212, Plan 8, NPL „Hortikultura“ SH.A produžava rok za objavljivanje za još 5 (pet) dana za ovaj konkurs:

KONKURS

Da popuni radno mesto

Zvanje: Vanjski konsultant za projekat u vezi

Izveštava: Glavnom Izvršnom Direktor

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Naknada: 800 eura (bruto) mesečno

Trajanje ugovora: na određeno vreme

Kvalifikacije i stručna obuka:

- visoko obrazovanje u oblasti arhitekture ili građevinarstva, pejzažne arhitekture ili inženjerstva zaštite životne sredine
- ima iskustvo u upravljanju i implementaciji projekata
- poznavanje softvera i programa Archicad, Autocad, Photoshop
- veštine timskog rada
- jake komunikacijske veštine
- ima radnu etiku i visok integritet
- poželjno je znanje engleskog jezika
- 5 godina iskustva

Dužnosti i odgovornosti:

- analizira, ocenjuje postojeće stanje jedinice cvečara
- izrađuje studiju izvodljivosti za predloženi projekat
- ocenjuje prethodno merenje i predračun
- daje savete o stvarnom stanju terena
- stalno koordinira sa jedinicom radi identifikovanja potreba

- prati raspoloživu vegetaciju u celini i predlaže uređenje projektantskog prikaza vegetacije, uključujući sadnju cveča, sadnju dendrološkog materijala, orezivanje ukrasnog drveća i slične radove u zelenilu
- analizira radne prakse i procedure u cilju povećanja efikasnosti i predlaže njihovu modifikaciju ili prilagođavanje prema potrebama i razvoju
- priprema godišnji plan prihoda i rashoda
- priprema srednjoročne i dugoročne planove jedinice
- za svoj rad odgovara Glavnom Izvršnom Direktor

Konkursna procedura

Službeni formular zainteresovani kandidati mogu preuzeti u Službi za ljudske resurse Preduzeća "Hortikultura" ili ga preuzeti sa web stranice www.hortikultura-pr.com. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji Sektoru za ljudske resurse na adresu ul. Tahir Zajmi, bb u Prištini, ili preko Pošte Kosova. Kandidati koji konkurišu moraju uneti tacnu adresu, kontakt telefon i email adresu. Na intervju će biti pozvani samo odabrani kandidati.

Uz prijavu se mora priložiti:

- obrazac prijave od JLP "Hortikultura";
- uverenja o školskoj spremi;
- dokaz o radnom iskustvu;
- kopiju lične karte
- uverenje suda kojim se dokazuje da nije osuđivan (ne starije od šest meseci)

Napomena: Prijave poslate poštom, na kojima se nalazi poštanski žig na pošiljci upucenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete u obzir ako stignu u roku od dva (2) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one nepotpune sa relevantnom dokumentacijom neće se razmatrati.

Nepotpune prijave i dokumentacija u skladu sa zahtevima navedenim u ovom oglasu, kao i oni koji pristignu nakon navedenog roka, neće se razmatrati.

Oglas je otvoren od 06.07.2023 – 10.07.2023.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Odjeljenju za ljudske resurse JLP "Hortikultura".



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ragip Fetiu nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Teuta Hasi nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Besjana Lleshi nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e Gjinnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Gazmend Fetiu nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e sh.m. t. "Nexhmedin Nixha" metalik automekanik Gjakovë.

- Dugagjin Blyta nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Mithat Haxhibeqiri nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e Gjinnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Taulant Mejzini nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e Gjinnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

Daut Rexhaj nga Gramaqel KK Decan Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Vëllaznim Rraci nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e sh.m. teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Daut Husi nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Altin Kamberi nga Gjakova shpall të pavarëshme diplomën e Gjinnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Nexhat Mehollit, shpall të pavarëshme dëftesat e shkollës fillore "TREPÇA".

Leutrim Shehi shpall të pavarëshme 1 dëftesë dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Erkan Gashi shpall të pavarëshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Bekim Hoti shpall të pavarëshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275